



RAPORT MONITORIMI 9 MUJOR MBI DOSJET PUBLIKE NË SPAK GUSHT 2022 – PRILL 2023



Tiranë, Maj 2023



Ky raport është pjesë e projektit "FOL PËR DREJTËSINË", që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës "FOL" dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Përgatiti: Z.Isuf Shehu, Ekspert i Jashtëm

Kontribuan në hartimin e raportit :

1.Znj. Bleona Metushi, Gazetare, Eksperte e Jashtëme

2.Znj. Esmeralda Keta, Gazetare, Eksperte e Jashtëme

Rishikoi:

Znj. Anila Hoxhaj, Gazetare, Drejtor Ekzekutiv Qendra “Fol”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Qendra “FOL”

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Qendra “FOL” në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rruga “Pjetër Budi” , godina numër 69, Tiranë

E-mail: gendrafol@gmail.com

Telefon: +355682082888

Përmbajtja e Punimit

Faqe

Hyrje.....4-5

KREU I

1.1 Veprat penale në fushën e Korrupsionit.....6-13

KREU II

2.1 Lufta kundër drogës dhe krimit të organizuar.....14-19

2.2 Problematika të hasura gjatë punës hulumtuese 9-të mujore.....20

2.3 Rekomandime dhe Gjetje.....21

HYRJE

Qendra Fol nëpërmjet ekspertëve të saj ka monitoruar për një periudhë 9 mujore veprimtarinë, procesin e procedimeve penale të regjistruara pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (kallëzimet publike).

Veprimtaria e ekspertëve u bazua në një metodologji të specifikuar monitorimi që u reflektua në ngritjen e një databaze, bazuar në domosdoshmërinë e reflektimit të të dhënave mbi kategorinë e figurave të veprave penale që janë pjesë e Kreut VIII, seksioni I, i Kodit Penal i cili parashikon figurat e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (neni 244, 244/a, 245, 245/1);

Seksioni II, *“Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”*, i cili parashikon nenin 257, 258 paragrafi 2, figurat e veprave penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259); korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë (neni 259/a); korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260);

Kreu IX, *“Vepra penale kundër drejtësisë”*, në të cilin parashikohen figurat e veprave penale të korrupsionit aktiv të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit (neni 312), korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319), korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/a), korrupsioni aktiv i arbitrit vendas edhe të huaj (neni 319/b), korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/c), korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319/ç), korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/d), korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj (neni 319/dh), korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja

(neni 319/e). Kreu XI i Kodit Penal, më konkretisht në nenet 333 (Organizata Kriminale), neni 333/a (grupi i strukturuar kriminal), neni 334 (kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal). Të gjitha veprat penale që në bazë të nenin 75/a te Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të SPAK.

Grumbullimi i të dhënave rreth këtyre kategorive të veprave penale u bë i mundur në kuadër të hulumtimit të praktikave hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë fazën e hetimeve paraprake deri në gjykimin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Me qëllim reflektimin objektiv të të dhënave të grumbulluara, databaza e ngritur nga ana e Qendrës “FOL” ka shërbyer si një arkivë e mirëfilltë dhe e strukturuar informacioni, e cila jemi të bindur se do të shërbejë pozitivisht dhe do të lehtësojë punën e mëtejshme të studiuesve të së drejtës, ekspertëve të fushës dhe të interesuarve për të hulumtuar mbi këto kategori të veprave penale. Në këtë databazë të aksesueshme online nga ana e publikut, ekspertët kanë reflektuar çdo rast që përbën vepër penale dhe është në kompetencë të SPAK, si dhe të gjithë procesin e procedimit të organit të akuzës si regjistrimi i veprës penale, caktimi i masës së sigurimit, disponimi në përfundim të afatit të hetimi nëpërmjet kërkesës për gjykim apo vendimit të mosfillimit.


Kreu I

1.1 Kategoria e veprave penale në fushën e korrupsionit:

Raporti i Qendrës Fol i referohet monitorimit të veprimtarisë së Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për një periudhë 9 mujore, 31.07.2022-01.05.2023. Raportimet janë si më poshte:

1. Janë monitoruar në total 69 raste të përfshira në këtë kategori ose rreth 59% e numrit total të të gjitha çështjeve të shqyrtuara (116), të cilat përfshijnë përveç kategorisë së korrupsionit, edhe kategorinë e veprave penale në fushën e drogës dhe krimin të organizuar. Më konkretisht 33 raste ose rreth 48% të regjistruara në vitin 2022, ndërkohë 36 raste ose rreth 52% janë regjistruar në vitin 2023.


2. Sa i përket të dhënave statistikore të monitoruara gjatë vitit 2022 rezulton se muaji Nëntor 2022 (14 raste) mban vendin e parë sa i përket periudhës kohore gjatë së cilës është regjistruar numri më i lartë i materialeve në fushën e korrupsionit, ndjekur më pas nga muaji Dhjetor 2022 (6 raste) dhe muaji Tetor 2022 (5 raste).



3. Për periudhën 31.07.2022-31.12.2022 shikohet një rritje e numrit të

rasteve nga 2 raste të regjistruara në muajin Gusht 2022.

4. Sa i përket të dhënave statistikore të monitoruara për periudhën 01.01.2023-01.05.2023 rezulton se muaji Mars 2023 (16 raste) mban vendin e parë sa i përket periudhës kohore gjatë së cilës është regjistruar numri më i lartë i materialeve në fushën e korrupsionit, ndjekur më pas nga muaji Prill 2023 (10 raste) dhe Shkurt 2023 (9 raste).



5. Për këtë periudhë shikohet një rritje e numrit të rasteve të regjistruara ne Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga 2 raste të regjistruara në muajin janar 2023.

6. Nga 69 raste të korrupsionit të referuara pranë organeve proceduese, rezulton se numrin më të lartë të subjekteve të përfshira e mbajnë zyrtarët dhe ish zyrtarët e bashkive (kryetar, nënkryetar), zyrtarët, ish zyrtarët, drejtor dhe ish drejtor të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Rastet e kallëzimit ndaj gjyqtarëve janë 3, ndërsa në 2 rastet e kallëzimit ndaj Prokurorëve të posacëm është vendosur mosfillim.


7. Shpërdorimi i detyrës i cili përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, në përputhje me parashikimin e nenit 248 të Kodit Penal është monitoruar nga ana e ekspertëve në 26 raste duke krijuar përshtypjen se kjo vepër penale tashmë përbën një ndër degëzimet kryesore në kategorinë e veprave

penale në fushën e korrupsionit. Kjo vepër penale hetohet nga Prokuroria e Posaçme vetëm kur kryhet nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur (neni 75/a gërma b e Kodit të Procedurës Penale), ose nga subjekte të posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a gërmat c dhe ç të Kodit të Procedurës Penale).

8. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.Pr.P. është vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në 6 raste. Në 6 raste, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar këtë masë dhe në 1 rast ankimi është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

9. Masa e sigurimit “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale është kërkuar nga Prokuroria e posaçme në 32 raste. Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur këtë masë në 26 raste. Në 12 raste ankimet janë lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Arrestin në burg duke qenë masa e sigurimit personal më e rëndë, mund të kërkohej nga Prokuroria dhe zbatohet nga gjyqtari vetëm kur masat e tjera janë të papërshtatshme. Referimi në masën e sigurimit “arrest në burg” kërkon një extrema ratio, të tillë që të bëjë në rastin konkret, për shkak të cilësive të vet rasti, kërkesa e masave të sigurimit nuk mund të përmbushet nga asnjë masë tjetër më e lehtë. Përshtatshmëria e çdo mase lidhet me rrezikshmërinë e veprës penale si dhe rrezikshmërinë e personit ndaj të cilit merret kjo masë.



10. Vetëm në 1 rast, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar ka rrëzuar kërkesën e Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg dhe ka vendosur masën e sigurimit arrest në shtëpi parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

11. Nga të dhëna statistikore dallojmë që përvec rasteve përcaktuara në grafik kur është vendosur masa e sigurimit “arrest ne burg” apo “arrest në shtëpi”, rastet e tjera hetohen në gjendje të lirë apo në masa te tjera ndaluese. Këto statistika cojnë në analizimin e disa faktorëve ndikues siç është politika penale humaniste drejt tendencës për ekzekutimin në nivele më të reduktuara të masave të sigurimit; niveli i lartë i pandëshkueshmërisë në rastin e veprave penale në fushën e korrupsionit; mungesa e kapaciteteve të autoriteteve proceduese për të ngritur akuzën mbi bazën e indicieve dhe provave përtej çdo dyshimi të arsyeshëm; ose perfeksionimi i mënyrës së kryerjes së veprës penale nga ana e ish-funksionarëve apo funksionarëve aktualë të lartë në institucione të nivelit qendror apo vendor, të cilët e shndërrojnë në të pamundur arritjen e objektivit për vënien para përgjegjësisë të autorit konkret.

12. Përfaqësuesit e organit procedues për 11 raste të dyshuar për kryerjen e veprave penale të korrupsionit aktiv parashikuar nga neni 244, 244/a dhe 245 i Kodit Penal kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest ne burg” vetëm në 4 raste dhe caktimin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi” në 1 rast. Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar në 3 raste ka bërë kërkesën për gjykim.

13. Përfaqësuesit e organit procedues për 17 raste të dyshuar për kryerjen e veprave penale të korrupsionit pasiv parashikuar nga neni 259, dhe 319/ç i Kodit Penal kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest ne burg” vetëm në 7 raste dhe caktimin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi” në 3 raste. Gjykata e shkallës së parë kundër Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar ka vendosur masën e sigurisë arrest në burg në 6 raste dhe arrest në shtëpi në 4 raste.


Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar në 2 raste ka bërë kërkesën për gjykim dhe në 2 raste ka vendosur mosfillim.

14. Deri në muajin Maj 2023, sipas të dhënave zyrtare të bëra publike nga SPAK rezulton se 69 materiale janë regjistruar, ku pjesa më e madhe e materialeve rezulton të jenë iniciuar kryesisht nga SPAK, përkatësisht 37 raste ose rreth 54% e tyre, ndjekur nga referimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, 4 raste janë referuar nga ana e subjekteve politike dhe pjesa tjetër janë referuar nga gazetarë dhe subjekte që ushtrojnë profesionet e lira.

15. Nga 69 rastet e monitoruara të veprave penale në fushën e korrupsionit vetëm 1 rast Prokuroria e Posaçme ë dergoi për kompetencë, në Prokurorinë e Tiranës pasi veprat penale dhe subjektet e kallëzuara nuk ishin në kompetencën e SPAK.

16. Sa i përket veprës penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i K.P dhe “Korrupsionit pasiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal ende nuk ka raste të referuara.

17. Nga 69 materialet e referuara pranë Prokurorisë së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në 12 raste ose rreth 17.3% e rasteve, Prokuroria ka regjistruar procedimin penal dhe ka dërguar kërkesë për gjykim, ndërkohë që në 4 raste (ose rreth 6%) organi procedues ka vendosur bazuar në nenet 290 e vijues K.Pr.P. mosfillimin e procedimit penal. Tabela si me poshtë:



18. Prokuroria e Posacme ka disponuar me kërkesë për gjykim në 16 raste ose 23% të rasteve dhe për pjesën tjetër të procedimeve është ende në fazën e hetimeve (ose rreth 77 % të rasteve). Gjatë 4 muajve të parë të vitit 2023 Prokuroria e Posacme nuk ka disponuar as me vendim mosfillimi apo kërkesë për gjykim.

19. Një moment i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë është afati i parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale për kryerjen dhe përfundimin e hetimeve, i cili ndryshon në varësi të statusit të subjektit, i cili mund të jetë “person që i atribuohet vepra penale” apo “person nën hetim”.

20. Afati 6 mujor brenda të cilit prokurori duhet të vendosë fillon/*a quo* të llogaritet apo të ecë, që ...nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, neni 323 i Kodit të Procedurës Penale. Në rastin e procedimeve të regjistruara pa autor, afatet janë të papërcaktuara.

21. Termin “person të cilit i atribuohet vepra penale” e gjejmë në nenin 287 të K.Pr.Penale që bën pjesë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të Kodit që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijëni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori, shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal.

Termi “person të cilit i atribuohet vepra penale” i marrë në kontekstin e nenit 287 të K.Pr.Penale plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”¹.


Në fazën e hetimeve paraprake kuptohet se ndryshon dhe gjendja juridiko-procedurale penale e autorit të mundshëm të veprës penale nga person që i atribuohet vepra penale në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime.

22. Referuar procedimeve penale të regjistruara me akuzën “vjedhje duke shpërdoruar detyrën” “Grup i strukturuar kriminal” “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, rezultojnë 2 raste të referuara. Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka vendosur mosfillim, Gjykata e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në të dy rastet ndryshoi vendimin e prokurorisë dhe vendosi

¹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 3 datë 27.09.2002.

kryerjen e hetimeve shtese. Çështjet kanë shkuar pranë Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar pas ankimit nga Prokuroria.

23. Pjesa më e madhe e personave të kallëzuar ashtu sic tregohet dhe në tabelën më poshtë janë zyrtarë dhe ish zyrtarë të ASHK, më pas ndiqet nga drejtues apo ish drejtues të institucioneve qendrore. Kallëzime në një përqindje më të reduktuar ka patur për funksionarë të sistemit gjyqësor 2 raste ndaj gjyqtarëve, 2 raste ndaj prokurorëve të posacëm, raste ndaj efektivëve të policisë. Kallëzime ka patur edhe ndaj kryetarëve, nënkryetarëve apo zyrtarëve të bashkive.



Kreu II

2.1 Kategoria e veprave penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar si dhe veprat penale në kuadër të akteve terroriste

Për veprat penale të të parashikuara në Kreun e XI të Kodit Penal, më konkretisht në nenet 333(Organizata Kriminale), neni 333/a(grupi i strukturuar kriminal), neni 334(kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal) rezulton se në regjistrin e veprave penale, kjo referuar raportimeve të Qendrës Fol, për periudhën 9 mujore janë regjistruar 47 raste, emrat e të cilave figurojnë të regjistruar në rregjistrin e veprave penale në SPAK brenda periudhës së hartimit të këtij raporti. Në total janë raportuar për periudhën nga 1 Gushti 2022 deri më 1 Maj 2023, bazuar në publikimet dhe informacionet e siguruar nga Drejtoritë përkatëse të Policisë së Shtetit por edhe nga deklaratat publike të vetë kallëzuesve gjithsej 6(gjashtë) procedime penale.

Procedimet Penale në fushën e Narkotikëve

1. SPAK ka regjistruar procedimin penal ndaj dhjetë personave të cilën në formën e posacme të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal dyshohen për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike parashikuar në nenin 283/a të Kodit Penal. Ky rast rezulton i raportuar më 4 Dhjetor 2022 dhe bazohet në komunikatën për shtyp të Policisë së Shtetit. Ndaj të gjithë personave që akuzohen për pjesmarrje në grup të strukturuar kriminal dhe trafikim të lëndëve narkotike, SPAK ka kërkuar për të gjithë të dyshuarit marrjen e masës së sigurimit “arrest me burg”, kërkesa të cilat janë pranuar nga Gjykata e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar(këtu e në vijim GJKKO). SPAK ka realizuar këtë procedim në bashkëpunim me organet ligjzbatuese të juridiksioneve të huaja të cilat kanë referuar informacione mbi bazën e të cilave nëpërmjet metodave speciale të hetimit është kryer fiksimi i provave dhe më pas arrestimi i të dyshuarve për veprën penale. Aktualisht për këtë procedim nuk rezulton që

nga ana e SPAK të jenë paraqitur përpara GJKKO kërkesë për pushim të akuzës apo të Kërkesë për dërgimin e cështjes në gjyq, për personat ndaj të cilëve po zhvillohen hetimet. Rezultate të mundshme të hetimeve mund të priten pas plotësimit të afatit 6 (gjashtë mujor) nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në regjistrat e prokurorisë SPAK, nëse kjo e fundit nuk do të paraqesë kërkesë për zgjatjen e afateve të paraburgimit dhe të hetimit. Vlen të theksohet se rasti i raportuar bën fjalë për një episod të vetëm kriminal, më konkretisht importimi i një sasive prej 430 kilogramëve lëndë narkotike e llojit kokainë e importuar nga Kolumbia, e përzierë brenda 26 tonëve pleh kimik.

2. Në Janar të vitit 2023, SPAK ka urdhëruar arrestimin e 21 personave të cilët në bashkëpunim ndërmjet tyre kanë konsumuar veprën penale të parashikuar në Kodin Penal në nenet 333/a “Grupi i Strukturuar Kriminal” dhe nenin 334 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”. Ky hetim është realizuar në bashkëpunim me autoritetet ligjzbatuese Italiane të cilat kishin evidentuar se në territorin italian kryen shpërndarjen e lëndëve narkotike, të llojit kanabis sativa, heroinë dhe kokainë. Këta persona kanë qënë në përgjim telematik në Itali prej vitit 2017 dhe në Shqipëri prej vitit 2019. Nga raportimet e Qendrës Fol nuk rezulton që autoritetet ligjzbatuese shqiptare Policia e Shtetit dhe Spak të kenë komunikuar dhe njoftuar publikisht ndonjë episod të mundshëm të shitjes parashikuar në nenin 283 “Prodhimi dhe Shitja e Lëndëve Narkotike”. Për këtë rast i cili është referuar nga autoritetet e huaja, që nga data e komunikimit dhe deri më 1 Maj 2023 nuk rezulton që të jenë kryer veprime të tjera procedurale nga ana e SPAK. Për të gjithë pjesëtarët e grupit të strukturuar kriminal, SPAK ka kërkuar marrjen e masës “arrest në burg”, kërkesë të cilat janë pranuar plotësisht nga ana e GJKKO. Ky është një procedim i iniciuar nga SPAK ndaj shtetasve shqiptarë të cilët kanë kryer vepra penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit

6 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Bazuar në të dhënat e raportuara nga Qendra Fol, konstatohet se këta persona nuk kanë kryer asnjë aktivitet kriminal, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal apo të kenë konsumuar elementë të veprës penale të “Prodhimit dhe Shitjes së Lëndës Narkotike” parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Në këtë rast konstatohet se organet ligjzbatuese shqiptare kanë marrë përsipër ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasve shqiptarë për veprime të ndërmarra në një shtet të huaj, në kushtet kur si Republika e Shqipërisë dhe ajo e Italisë kanë nënshkruar marrëveshjen bilaterale për ndihmë të ndërsjelltë juridike dhe ekstradimin, por krahas kësaj edhe atë të transferimit të procedimeve penale.

Nga komunikimet e raportuara konstatohet se grupi i strukturuar kriminal ka konsumuar dhe ka ndërmarrë veprime kriminale vazhduese, ndryshe nga rasti i raportuar në pikën 1 ku bëhet fjalë për një episod të vetëm kriminal.

Procedimet Penale për veprat penale kundër jetës të kryera më dashje

3. Për veprën penale të Vrasjes në Rrethana Cilësuese parashikuar në nenin 79, “Vrasjen e Funkionarëve Publikë, mbetur në tentativë”, parashikuar në nenin 79/a dhe 22, si dhe “Sigurimi i kushteve për vrasjen” parashikuar në nenin 80 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar në nenet 33/a dhe 334 të Kodit Penal, rezulton se pranë SPAK në rregjistrin e veprave penale figurojnë 9 persona. Ky rast që i përket episodit të ndodhur në vitin 2019, ku mes personave të tjerë të veprës penale ishte edhe një funksionar publik me detyrë prokuror, pranë prokurorisë së rrethit. Për të gjithë personat të cilët dyshohen si bashkë autorë të veprave penale të sipërcituara, SPAK ka kërkuar dhe urdhëruar arrestimin e tyre. Kërkesat për caktimin e masave të arrestit për të 9(nëntë) persona të dyshuar për këto krime janë pranuar dhe miratuar nga GJKKO.

4. Vlen të theksohet se më datën 30 Prill 2023 subjekt i SPAK për veprat penale të parashikuara në Kreun XI të Kodit Penal, është edhe një prej anëtarëve të Kuvendit, Deputeti Sali Berisha ndaj të cili është paraqitur kallëzim penal shtetasit Muharrem Haklaj dhe Zylfije Haklaj. Sipas tyre, Sali Berisha (ish president i Shqipërisë); Perparim Hyka , Myftar Lumneshi, Hajredin Haluci, Haki Hoxha, Tahir Hoxha, Iljaz Hoxha, Ilir Hoxha, Selim Hoxha, Agim Hoxha, Cut Neza, Sadri Neza, Xhafer Hoxha, Medi Hoxha, Guxim Byberi, për kryerjen e veprave penale "Vrasje me paramendim" parashikuar nga neni 78/2, i Kodit Penal, "Krijimi i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale", parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, "Kryerja e krimeve nga banda e armatosur dhe organizata kriminale" parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal, "Aktet terroriste", parashikuar nga neni 230 i Kodit Penal. Kallëzimin në SPAK e ka kryer avokati Idajet Beqiri (në kallëzim përmend së është i pajisur me prokurë nga Muharrem Haklaj dhe Ajshe Haklaj). Ky procedim hetimor nuk reflekton asnjë veprim procedural përpara GJKKO. Personi që i atribuohet vepra penale, nuk është thirrur për të dhënë shpjegime qoftë në këtë cilësi apo ndonjë cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale.

Mashtrimi Kompjuterik

5. Referuar procedimeve penale të regjistruara me akuzën "Mashtrim Kompjuterik" neni 143/b i Kodit Penal, "Grup i strukturuar kriminal", rezultojnë 5 raste të referuara. 3 persona janë marrë në procedim penal si anëtare të një grupi të strukturuar kriminal dhe 2 të tjerë janë proceduar si anëtare të një grupi të strukturuar kriminal tjetër. Në të gjitha rastet organi i akuzës ka kryer hetimet në bashkëpunim me autoritetet e huaja.

Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" për 2 raste dhe "arrest në shtëpi" për 2 raste. Gjykata e Posacme kundër Korrupsionit dhe


Krimin të Organizuar ka pranuar kërkesën e Prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit.

Veprat Penale me Qëllime Terroriste

6. Në këtë periudhë 9 mujore pjesë e veprimtarisë së SPAK ka qënë edhe hetimi dhe ushtrimi i ndjekjes penale ndaj personave për veprat penale të parashikuara në Kreun VII “Veprat Penale me Qëllime Terroriste”. Më konkretisht është raportuar një rast për veprën penale të “Kanosjes për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” parashikuar në nenin 232/b të Kodit Penal. Ndaj këtij personi SPAK ka kërkuar caktimin e masës së “arrestit me burg”, masë e cila është miratuar nga GJKKO.

Të dhëna statistikore mbi veprat penale në fushën e drogës dhe krimin të organizuar si dhe veprat penale në kuadër të akteve terroriste

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në 6(gjashtë) procedime hetimore për veprat penale të parashikuara në Kreun VII dhe XI dhe janë marrë në 31 persona janë në hetim për veprat penale që lidhen me “shitjen” dhe “trafikimin” e lëndëve narkotike, të cilët përbëjnë 66% të të proceduarve, ndërsa për veprën penale të “Mashtimit Kompjuterik” rezultojnë 5 persona që përbëjnë 10% të të proceduarve. Vlen të theksohet se krahas veprave penale të fushës narkotike, rezultojnë se në total 10 persona që janë në proces hetimor për “Veprat Penale Kundër Jetës të Kryera me Dashje”, Kreu II, i Kodit Penal përbëjnë 21 % të të proceduarve. Ndërsa për Veprat Penale me “Qëllime Terroriste” vetëm një rast, ose 2% të të proceduarve. Tabela referon si më poshtë:



Në lidhje me pozitën dhe ushtrimin e funksioneve që ushtrojnë rezultojnë vetëm 4% e të proceduarve që në kohën që janë marrë në cilësinë e personave ndaj të cilëve u atribuohet vepra penale kanë qenë në ushtrim e sipër të një detyre publike ose pranë një entiteti publik.

2.2 Problematika të hasura gjatë punës hulumtuese 9-të mujore

Gjatë fazës së monitorimit për hartimin e këtij raporti vlerësimi 9 mujor konstatohet se baza burimore e informacioneve të raportuara dhe të analizuara në të shumtin e rasteve vjen nga komunikatat e Policisë së Shtetit. Referuar edhe ëbsitit të Spak <https://spak.al/category/media/> komunikimet janë sporadike dhe jo periodike. Në garantim të të drejtës për informim por edhe të mbrojtjes së të dhënave personale, aktet finale të procedimeve Gjyqësore, në rastet kur nuk dëmtohen hetimet dhe nuk çënohet sekreti hetimor SPAK duhet të garantonte përcjelljen e tyre në publik.

Kjo përbën një problematikë të zgjidhshme nga ana e SPAK, për aq sa në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” të ndryshuar, redaktimi i vendimeve Gjyqësore, duke fshehur të dhënat sensitive dhe personale do të garantonte transparencë publike dhe mediatike si dhe do të ndikonte në rritjen e besueshmërisë së publikut në Institucione.

Një problematikë tjetër që haset është aksesimi në databazën e faqes zyrtare të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në faqen e ëëë.gjykata.gov.al është i cunguar. Për efekt të informimit të publikut, por edhe të medias, duhet të garantohet aksesimi i plotë në to.

2.3 Rekomandime dhe Gjetje

Raportimet e Qendrës Fol, japin disa të dhëna shumë interesante të cilat kërkojnë adresimin e vëmendjes si nga ana e Strukturave Drejtuese të Spak por edhe të Vetë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Së pari, konstatohet se nuk ka asnjë referim nga organet ekzekutive në fushën e tatim-taksave, madje nuk ka asnjë referim/njoftim publik, nisur nga raportimet e bëra as nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Së dyti, konstatohet se Procedimet e SPAK kanë një vektor me kah dhe drejtim të përcaktuar, rastet referohen/njoftohen nga Policia e Shtetit, ose vetë procedimi është reagim i një ngjarje të caktuar, kriminale.

Së treti, asnjë prej procedimeve të marra kryesisht nuk reflektojnë gjetjet e publikuara në raportet vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përsa i përket performancës institucionale të administratës publike qendrore dhe vendore në Republikë.

Së katërti, duhet rritur bashkëpunimi me agjensitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve. Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar i duhet dhënë prioritet krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja të drejtësisë, nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e organizmave ndërkombëtare.